



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

THIRRJE PËR APLIKIM

Për licencimin e operatoreve ekonomik për organizimin e transportit Taxi të Udhëtareve: **Taksi Individual/Taksi i Kryeqitetit (Person fizik);**

Duke u bazuar në Rregulloren për ushtrimin e veprimtarisë taksi të udhëtarëve me numër 01/346/02-257624/22 të datës 25.11.2022, përmes së cilës përcaktohet mënyra e kryerjes dhe organizimit të transportit të udhëtarëve me taksi në territorin e Kryeqitetit.

Taksi Individual/Taksi i Kryeqitetit (Person fizik) të cilët aplikojnë për tu pajisur me licenca për organizimin e transportit taksi të udhëtarëve, duhet të paraqesin këto dëshmi:

1. Të jetë i/e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK);
2. Përparsi do të kenë personat të cilët kanë në pronësi veturen elektrike ose hibride, por do të ipet mundësia edhe me vetura tjera me një kushtë që pas një viti të paisen me vetur hibride ose elektrike.
3. të jetë banor/e i/e Kryeqitetit (dëshmi për vendbanim);
4. të jetë i/e pajisur me certifikatën që dëshmon se nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj);
5. të jetë i/e pajisur me certifikatën e mjekut (jo më e vjetër se 6 muaj);
6. Dy (2) fotografi;

Taksi individual/Taksi i Kryeqitetit(Person fizik) duhet që vetura:

1. Të jetë me pesë(4+1) ulëse;
2. Të ketë timonin në krahun e majtë dhe së paku katër(4) dyer;
3. Të jetë i vendosur Taximetri;

4. Automjeti të jetë në gjendje të rregullt.

Taksi Individual/Taksi i Kryeqytetit (Person fizik) të cilët plotësojnë kushtet sipas Rregullores të dt.25.11.2022 do të pajisjen me "Leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste për organizmin e transportit taksi të udhëtarëve , në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve me mundësi vazhdimi.

Të gjitha përgjegjësit dhe obligimet tjera të ushtrimit të veprimtarisë të transportit taksi, rregullohen sipas Rregullores për ushtrimin e veprimtarisë taksi të udhëtarëve duke u bazuar në Rregulloren 01/346/02-257624/22 të datës 25.11.2022:

<https://kk.rks-gov.net/prishtine/wp-content/uploads/sites/45/2022/12/7.-Vendim-per-miratimin-e-Rregullores-per-auto-taxi.pdf>

Afati për alikim është prej datës 14.04.2025-05.05.2025

Aplikimi së bashku me dokumentet e lartshënuara duhet të dorëzohet në objektin e vjetër të Komunës së Prishtinës, kati përdhese , sporteli nr.1.